

L I G J

Nr.8299 DATE 4.3.1998

FZ. 7-1998

PER RATIFIKIMIN E "MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE  
SHQIPTARE DHE QEVERISE MAQEDONASE PER EKSTRADIMET"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për Ekstradimet"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2013, datë 12.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani

**MARREVESHJE**  
**PER EKSTRADIMET**  
**NDERMJET**  
**QEVERISE SHQIPTARE DHE QEVERISE MAQEDONE**

Per te intensifikuar bashkepunimin e metejshem ne fushen e gjykimeve penale, per te krijuar bazen ligjore dhe per te lehtesuar procedurat lidhur me ekstradimet, Qeveria Shqiptare dhe Qeveria Maqedone rane dakord te lidhin kete marreveshje:

**Neni 1**

**Objekti i Marreveshjes**

Te dy palet ndermarrin detyrime qe ne perputhje me kete marreveshje te ekstradojne reciprokisht persona te cilet ndiqen per nje veper penale te kryer ne ose kunder vendit qe kerkon ekstradimin, ( tani e tutje do te quhet "Vendi Kerkues" ), ose lidhur me ekzekutimin e nje vendimi te formes se prere me burgim ose mase sigurimi te dhene ne ate vend.

**Neni 2**

**Menyra e Komunikimit**

- (1) Organet kompetente realizojne ekstradimet nepermjet Ministrive te Drejtesise te te dy paleve.
- (2) Ne raste urgjente kerkesa per ekstradim mund te drejtohet edhe nepermjet INTERPOLIT.

**Neni 3**

**Gjuha dhe Legalizimi**

- (1) Kerkesa per ekstradim dhe dokumentat qe duhet t'i bashkengjiten sipas kesaj marrveshjeje duhet te jene ne gjuhen e vendit qe i kerkohet ekstradimi ( tani e tutje do te quhet "Vendi i Adresuar" ).
- (2) Vendi kerkues mban pergjegjisi per autenticitetin dhe rregullsine e dokumentave te mesiperme ne perputhje me legjislacionin e vet, prandaj legalizimi i tyre eshte i panevojshem.

## **Neni 4**

### **Dokumentacioni**

Kerkeses per ekstradim duhet t'i bashkengjitet:

1. Te dhena identifikuese per personin per te cilin kerkohet ekstradimi.
2. Certificate te organit kompetent qe konfirmon shtetesine e personit per te cilin kerkohet ekstradimi.
3. Kopjen origjinale ose te vertetuar te aktit te procedimit, te mases se sigurimit ose te vendimit te formes se prere te denimit me burgim.
4. Ekstrati i dispozitave penale te aplikuara ndaj personit per te cilin kerkohet ekstradimi.
5. Te dhena lidhur me denimin e mbetur per rastet kur eshte vuajtur nje pjese e tij.

## **Neni 5**

Vendi i Adresuar mund te kerkoje informacion ose dokumentacion shtese nese te dhenat e parashikuara nga neni 4 i kesaj marreveshje nuk jane plotesuar, jane te pasakta ose jo te mjaftueshme. Ne keto raste vendi kerkues detyrohet te plotesoje kerkesen sa me pare por jo me vone se 60 dite nga paraqitja e saj.

## **Neni 6**

(1) Ne se vendi kerkues nuk e paraqet informacionin ose dokumentacionin e kerkuar brenda afatit te nenit 5 te kesaj marreveshje, Vendi i Adresuar nderpret proceduren per ekstradim dhe anullon cdo veprim te ndermarre ndaj personit perkates.

(2) Kur me kerkesen e te interesuarit, gjykata e Vendit te Adresuar ka njohur shperblimin e demit per efekt izolimi gjate ekstradimit, ai perballohet nga Vendi Kerkues.

## **Neni 7**

### **Veprat Penale per te Cilat Lejohet Ekstradimi**

(1) Ekstradimi per shkak te ndjekjes penale ose mases se sigurimit te marre lejohet vetem kur me ligjin e te dy vendeve parashikohet per vepren penale perkatese nje denim me burgim jo me pak se 1 vit.

(2) Ekstradimi per zbatimin e nje vendimi denimi lejohet vetem kur eshte dhene nje vendim me burgim i formes se prere per t'u vuajtuar jo me pak se 6 muaj.

## **Neni 8**

### **Moslejimi i Ekstradimit**

Ekstradimi nuk lejohet per:

1. personat te cilet jane shtetas te Vendit te Adresuar ditin qe ka mberritur kerkesa per ekstradim.
2. personat pa shtetesi me vendbanim te perhershem ne territorin e Vendit te Adresuar.
3. personat qe gezojne te drejten e strehimit ne Vendin e Adresuar ditin e mberritjes se kerkeses.
4. personat me shtetesi te huaj, kur me shtetin perkates ka marreveshje te ndryshme.
5. Ne se ka arsye te mendohet se do te ushtrohet persekutim ose diskriminim i cfaredo lloji qe cenon te drejtat dhe lirite themelore te njeriut.

## **Neni 9**

Ekstradimi nuk lejohet ne se:

1. kerkohet per nje veper qe sipas ligjit te Vendit te Adresuar konsiderohet veper penale me karakter politik ose ushtarak,
2. ndjekja penale ose zbatimi i denimit sipas ligjit te Vendit te Adresuar konsiderohet i parashkruar ose i perfunduar,
3. vepra per te cilen ndiqet penalisht ose eshte denuar nuk perben veper penale sipas ligjit te te dy vendeve,
4. vertetohet qe denimi i dhene per te njejten veper ka qene ekzekutuar ose procedimi apo gjykimi penal ka pushuar per mos kryerje te vepres ose eshte dhene pafajesi per te,
5. per personin qe kerkohet ka nisur nje procedim, eshte marre nje mase sigurimi apo nje vendim denimi per te njejten veper ose vepra te tjera ne Vendin e Adresuar.

## **Neni 10**

Kur per vepren penale ne ligjin e Vendit Kerkues parashikohet denim me vdekje dhe sipas ligjes se Vendit te Adresuar nuk parashikohet nje denim i tille, ekstradimi mund te lejohet vetem me kushtin qe denimi me vdekje nuk do jepet ose nuk do te ekzekutohet.

## **Neni 11**

### **Amnistia**

Amnistia e shpallur ne Vendin e Adresuar nuk eshte pengese per ekstradimin.

## **Neni 12**

### **Refuzimi i Ekstradimit**

Ekstradimi mund te refuzohet kur:

1. vepra penale per te cilin kerkohet ekstradimi eshte kryer ne territorin e Vendit te Adresuar, eshte kunder atij vendi ose shtetasve te tij.
2. ne Vendin e Adresuar ka nisur procedimi ose zhvillohet nje gjykim penal per nje veper tjeter.
3. personi per te cilin kerkohet ekstradimi i eshte dhene pafajesi per te njejten veper ne Vendin e Adresuar ose eshte pushuar ceshtja per kete shkak.

## **Neni 13**

Kur kerkohet zbatim i nje vendimi penal te dhene ne mungese, ekstradimi lejohet vetem kur vendi kerkues jep garanci se pas ekstradimit do te zhvillohet nje gjykim i ri ne prezenca te tij.

## **Neni 14**

### **Shtyrja e Ekstradimit dhe Ekstradimi i Perkohshem**

(1) Kur nje person per te cilin kerkohet ekstradimi ne zbatim te nje vendimi denimi, eshte proceduar apo denuar ne Vendin e Adresuar per nje veper tjeter penale, ekstradimi i lejuar shtyhet deri ne perfundimin e ceshtjes dhe ne rast denimi, deri ne vuajtjen e tij.

ekstradim dhe dokumentacionin perkates, ne te kunderten masat shtrenguese revokohen automatikisht.

### **Neni 18**

#### **Vendimi per Lejimin e Ekstradimit**

(1) Per cdo kerkese per ekstradim eshte e detyrueshme te merret vendim nga organi kompetent per lejimin ose jo te ekstradimit duke u njoftuar per kete Vendi Kerkues.

(2) Cdo refuzim i plote ose i pjesshem i kerkeses per ekstradim duhet te argumentohet.

### **Neni 19**

#### **Dispozita te Vecanta ( Parimi i Specialitetit )**

(1) Personi i ekstraduar mund te ndiqet, te denohet ose ndaj tij mund te zbatohet nje vendim denimi vetem per vepren penale per te cilen eshte lejuar ekstradimi.

(2) Personi i ekstraduar mund te ndiqet penalisht vetem per vepra te tjera te kryera pas ekstradimit.

(3) Kunder personit te ekstraduar nuk mund te vihet ne zbatim nje denim penal per veper tjeter penale te kryer para ekstradimit.

(4) Kunder nje personi nuk mund te zbatohet nje denim me i rende se ai qe permban vendimi i denimit per te cilin eshte lejuar ekstradimi.

(5) Nuk mund te behet ekstradimi tek nje shtet i trete pa pelqimin e vendit qe ka lejuar ekstradimin.

### **Neni 20**

Kufizimet nga paragrafet 2, 3 dhe 5 te nenit 19 nuk kane efekt:

1. ne se Vendi i Adresuar ka dhene pelqimin fillimisht ose me kerkese te vecante.

2. kur i ekstraduari edhe pse ka patur mundesi, nuk ka lene territorin e vendit ku ai eshte ekstraduar pasi kane kaluar 45 dite nga lirimi i tij ose pasi e ka lene ate eshte kthyer vullnetarisht.

3. ne se gjate gjykimit ne Vendin e Adresuar eshte bere ndryshim ne kualifikimin ligjor te vepres, personi i ekstraduar mund te ndiqet penalisht ose te denohet vetem nese ekstradimi lejohet per cilesimin e ri te vepres.

### **Neni 21**

Ne se personi i ekstraduar eshte ndaluar ne vendin pale ne marreveshje per shkak te nje vepre penale per te cilen ekstradohet, koha e kaluar ne ndalim llogaritet ne denim.

### **Neni 22**

#### **Trupa e Shoqerimit**

(1) Trupa e shoqerimit e ngarkuar per te sjelle personin qe do te ekstradohet ose per ta rikthyer ka te drejte te marre cdo mase per te parandaluar arratisjen e tij ne territorin e vendit tjetër, gjate gjithë kohes se shoqerimit.

(2) Trupa e shoqerimit ka uniformen, armet mbrojtese dhe pajisjet e nevojshme te vendit te vet. Armet mund te perdoren vetem ne rastet e mbrojtjes se nevojshme.

### **Neni 23**

#### **Dorezimi i Sendeve te Sekuestruara ose te Konfiskuara**

(1) Sendet, letrat e shkruara, materialet, dokumentat dhe aktet mund te sekuestrohen ose konfiskohen dhe ti dorezohen Vendi Kerkues ne pajtim me ligjin e Vendi te Adresuar vetem mbi bazen e nje vendimi te leshuar nga organi kompetent i Vendi Kerkues.

(2) Kur me rastin e ndalimit personit i gjenden sende te tjera te cilat mendohet sa kane lidhje me ceshtjen per te cilen kerkohet ekstradimi, sekuestrimi i tyre behet kryesisht nga Vendi i Adresuar.

(3) Kur eshte rasti qe sipas ligjes se Vendi te Adresuar ka vend, behet sekuestrimi edhe i sendeve te tjera qe nuk kane lidhje me ceshtjen, te cilat Vendi i Adresuar mund t'i vecoje dhe t'i mbaje per procedim penal te vecante.

(4) Vendi i Adresuar mund te shtyje dorezimin e sendeve te sekuestruara ose konfiskuara ne rastet kur kane lidhje me nje procedim ose gjykim per veper tjetër penale ne ate vend.

(5) Vendi Kerkues pas mbarimit te procedures per te cilen eshte bere ekstradimi kthen materialet e parashikuara ne piken 1 dhe 2 te ketij neni ne rast se nuk eshte vendosur konfiskimi perfundimisht, pervec kur Vendi i Adresuar pranon ndryshe.

## Neni 24

(1) Ne se ekstradimi lejohet per nje person, lejohet edhe dorezimi i sendeve te sekuestruara pa bere kerkese kur:

1. sendet do te perdoren si prove materiale.

2. sendet te cilat personi qe do te ekstradohet i ka marre gjate kryerjes se vepre penale, i ka kembyer ose i ka konvertuar ato ne para per kryerjen e vepres penale.

(2) Ne se ekstradimi i cili ne baze te kesaj marreveshjeje mund te lejohet, por behet i pamundur per shkak te arratisjes ose vdekjes se personit, ose nuk eshte e mundur te gjendet ne territorin e Vendit te Adresuar, dorezimi i sendeve mund te lejohet.

(3) Ne asnje rast nuk lejohet shkelja e te drejtave se Vendit te Adresuar ose e personave te tjere. Mbi bazen e kesaj Vendi Kerkues i kthen Vendit te Adresuar sendet, pa pagese, pas mbarimit te procedures dhe sa me shpejt te jete e mundur.

(4) Gjate kryerjes se dorezimit ne zbatim te ketij neni nuk aplikohen rregullat per eksportimin dhe importimin e mallrave apo valutes se huaj.

(5) Dorezimi i sendeve te vjedhura personit te demtuar mund te behet perpara ekstradimit nese vendi pale ne marrveshje jep pelqimin per kthimin e tyre drejtpersedrejti personit te demtuar.

## Neni 25

### Procedura dhe Njoftimet

(1) Nese me kete marreveshje nuk eshte percaktuar ndryshe per proceduren lidhur me ekstradimin ose arrestimin ne territorin e shtetit te adresuar, aplikohet e drejta e shtetit te adresar. Vendi i Adresuar nuk mban pergjegjesi per rregullsine e kerkeses dhe dokumentacionit per ekstradim te derguara nga vendi kerkues.

(2) Nese personi ekstradohet per nje ndjekje penale, Vendi Kerkues i kerkon Vendit Adresues rezultatin e procedimit apo gjykimit penal. Vendimi i organit kompetent jepet ne original ose nje kopje e vertetuar nga ai organ.



## **Neni 26**

### **Kalimi Tranzit**

(1) Nese per ekstradimin e nje personi nga nje vend i trete ne nje vend pale te kesaj marreveshje lind nevoja e transportimit te tij neper territorin e pales tjeter, lejohet tranziti duke aplikuar te njejtat kushte si per ekstradimin me perjashtim te rasteve kur palet vendosin ndryshe.

(2) Kerkesa per lejimin e tranzitit duhet te permbaje te gjitha kerkesat te parashikuara ne nenin 4 te kesaj marreveshjeje.

(3) Vendi i Adresuar mund te refuzoje kerkesen per lejimin e tranzitit permes territorit te tij nese kerkesa eshte per nje person kunder te cilit ka filluar ndjekje penale ne ate vend apo eshte dhene nje denim i cili nuk eshte ekzekutuar akoma apo sipas mendimit te Vendit te Adresuar, tranziti sipas paragrafit te pare te ketij neni do te demtonte interesat e ketij vendi.

(4) Vendi pale ne marrveshje neper territorin e te cilit personi do te transportohet, nuk mund ta ndjeke ate penalisht per nje veper te kryer gjate transportit tranzit, dhe nje vendimi penal nuk duhet te ekzekutohet kunder tij pa pelqimin e Vendit Kerkues.

## **Neni 27**

(1) Ne se kalimi tranzit behet me linje ajrore, nje miratim i percaktuar shprehimisht nuk eshte i nevojshem.

(2) Ne rastin e nje uljeje te paparashikuar njoftimi per kalimin tranzit ka te njejtin efekt sikurse edhe kerkesa per mase sigurimi paraprak sipas nenit 16 te kesaj marreveshjeje.

## **Neni 28**

Dispozitat per trasportimin sipas kesaj marrveshjeje zbatohen edhe per ekstradimin e nje personi nepermjet territoreve te te dy vendeve, ne ekzekutim te nje mase sigurie ose vendimi denimi nga gjykata e nje vendi te trete. E njejtja gje zbatohet edhe per nje person qe ekstradohet me kerkese te vendit pale ne marreveshje nga pala tjeter, neper territorin e nje pale te trete.

## Neni 29

### Tarifat dhe Shpenzimet

- (1) Shpenzimet per ekstradim perballohen nga vendi pale ne marreveshje ne territorin e se cilit jane te jane regjistruar.
- (2) Shpenzimet per tranzit dhe tarifat perballohen nga Vendi Kerkues.
- (3) Transporti ajror perballohet nga vendi i cili ka propozuar ate.

## Neni 30

### Dispozita te Fundit

Kjo marreveshje nuk ka efekt mbi detyrimet qe rrjedhin nga marreveshjet shumepaleshe.

## Neni 31

Kjo marreveshje duhet te ratifikohet ne perputhje me legjislacionin e brendshem te secilit vend dhe hyn ne fuqi 30 dite pas shkembimit te instrumentave te ratifikimit.

## Neni 32

Kjo marreveshje eshte e lidhur per nje periudhe te pa kufizuar. Cdo pale mund te heqe dore nga kjo marreveshje ne rruge diplomatike ne nje afat prej 6 muaj mbas njoftimit me shkrim.

Kjo marreveshje eshte lidhur ne dt. 15. 01. 1998, Shkup, ne gjuhen shqipe dhe maqedone nga 2 origjinale per secilen, qe jane te barazvlefshme.

PER QEVERINE SHQIPTARE

*Tringjo Konej*

PER QEVERINE MAQEDONE

*J. Ljacob*